



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASHKISË
TEPELENË

Nr.1917/6 prot.

Tepelenë më, 01 . 09. 2022

V E N D I M

Nr.70. Datë.31.08.2022

“Për miratimin e listës me sipërfaqet e tokave bujqësore për tu dhënë me qera ndodhur në Bashkinë Tepelenë”

Në mbështetje të nenit 8 “Ushtrimi i autoritetit me interes publik vendor” dhe të nenit 9 “Të drejtat dhe përgjegjësitë”, neni 2 i ligjit nr. 8312, datë 26.03.1998 “Për tokat bujqësore të pandara”, neni 3 i ligjit nr. 8744, datë 22.02.2001 “ Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në tokat bujqësore të pandara” i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 510, datë 10.06.2015 “Për miratimin e procedurave për transferimin e të drejtave dhe detyrimeve, personelit, aktiveve të trupëzuara e të patrupëzuara” si dhe pika 5 dhe 11 e Udhëzimit nr.1 , datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” dhe Udhëzimit nr.2, datë 20.04.2016 “Për shfuqizimin e udhëzimit nr.3, datë 27.11.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për pezullimin e përkohshëm të udhëzimit nr.1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara”; mbështetur në të dhënat e certifikatave të pasurive rezulton që sipërfaqet e kërkuara bëjnë pjesë në ZK 1565, 3574, 1913 dhe 3177 përkatësisht të njëjse administrative Qendër , Tepelenë dhe Kurvelesh, kartelave të pasurive;

V E N D O S I:

1. Për miratimin e listës me sipërfaqet e tokave bujqësore për tu dhënë me qira, sipas funksionit dhe destinacionit që kanë:
 - Pasuritë me nr.82/1, ZK 1565, fshati Dukaj, lloji i pasurisë “Arë” në përdorim të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.
 - Pasuritë me nr.82/2, ZK 1565, fshati Dukaj, lloji i pasurisë “Arë” në përdorim të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.



- Pasuritë me nr.1/259, ZK 3574, fshati Mamaj, lloji i pasurisë ``Arë`` në përdorim të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.
- Pasuritë me nr.2/73, ZK 3574, fshati Mamaj, lloji i pasurisë ``Pa Frut`` në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.
- Pasuritë me nr.747, ZK 1913, fshati Gusmar, lloji i pasurisë ``Arë`` në përdorim të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.
- Pasuritë me nr.127, ZK 3177, fshati Rexhin, lloji i pasurisë ``Arë`` në përdorim të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.
- Pasuritë me nr.187, ZK 2404, fshati Lekdush, lloji i pasurisë ``Pa Frut`` në pronësi të Bashkisë Tepelenë sipas kartelës së lëshuar nga ASHK dhe HTR bashkëlidhur.

Të dhënat e tokave bujqësore sipas tabelës së mëposhmtë:

Nr	Njësia administrative/fshati	Zona kadastrale	Nr pasurie	Sipërfaqe m ²
1	Qendër/ Dukaj	1565	82/1	36734
2	Qendër/ Dukaj	1565	82/2	13008
3	Tepelenë/ Majkosh	3574	1/259	1200
4	Tepelenë/ Majkosh	3574	2/73	10326
5	Kurvelesh/ Gusmar	1913	747	11631
6	Kurvelesh/ Rexhin	3177	127	13808
7	Kurvelesh/ Lekdush	2404	187	53745

2. Ky proces të kryhet nëpërmjet procedurave të konkurrimit publik dhe elementeve të tij, në mbështetje të udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” si dhe në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e fondit tokë bujqësore.
3. Për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e korrespondencës, plotësimin e dokumentacionit si dhe për kryerjen e procedurave të mëtejshme në përputhje me përcaktimet e Udhëzimit nr. 1, datë 18.07.2012, të Këshillit të Ministrave “Për procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara” ngarkohet Kryetari i Bashkisë, Komisioni i Qiradhënies së Tokave bujqësore të pandara.

4. Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr. 139/2015 për “Vetëqeverisjen vendore” dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Gjirokastrë.

KRYETAR

Elvis Shehu

Sekretari I Këshillit Bashkiak
Valbona Çela

Miratuar me 12(dymbëdhjetë) vota

Vota Pro 12 (dymbëdhjetë)

Vot a Kundër -

Vota Abstenim -

Zbardhur më datë 01.09.2022.

